



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 124, Datë 19.06.2024

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 116, DATË 24.05.2022,  
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK  
“BLUE 1” ME VENDNDODHJE NË ZONËN E SHEQ MARINAS, BASHKIA FIER, ME  
KAPACITET TË INSTALUAR 50 MW”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.06.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 833/3 prot., datë 14.06.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.05.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1” me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 MW”, i ndryshuar,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 116, datë 24.05.2022, i ndryshuar me vendimin nr. 65, datë 12.04.2024, ka vendosur të licencojë shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1”, me kapacitet të instaluar 50 MW, për një afat 25 vjeçar, duke filluar ky afat nga dokumentimi në ERE i testimit/komisionimit të centralit, por jo më vonë se data 09.07.2026.
- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e bordit nr. 65/2024 me shkresën nr. 833/2 prot., datë 16.04.2024.
- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 715/3 prot., datë 24.05.2024, shoqëria “SPV BUE 1” sh.p.k. ka bërë me dije se më datë 23.05.2024 ka nënshkruar me shoqërinë OST sh.a. Marrëveshjen e Operimit në Rrjetin e Transmetimit të Parkut Fotovoltaik “Blue 1”, marrëveshje e cila është nënshkruar pas kalimit të fazës së testeve 72-orëshe të monitoruara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, ndërsa me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 715/4 prot., datë 30.05.2024, shoqëria ka depozituar dhe Marrëveshjen e Operimit në Rrjetin e Transmetimit të Parkut Fotovoltaik “Blue 1” me nr. 2935 prot., datë 23.05.2024, lidhur ndërmjet OST sh.a. dhe shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. Pjesë e kësaj marrëveshjeje janë dhe testimet e centralit të kryera në praninë e përfaqësuesve të OST sh.a.

- Duke qenë se shoqëria “SPV BLUE 1” sh.p.k. ka dokumentuar testimin dhe energjizimin e centralit fotovoltaiik, propozojmë pranimin e kërkesës së saj dhe ndryshimin e pikës 1 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 116/2022, i ndryshuar, duke e nisur fillimin e afatit 25-vjeçar te licencës së saj në datën 23.05.2024.
- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Pika 1 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.05.2022, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:
  1. *Të licencojë shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Blue 1”, me kapacitet të instaluar 50 MW, për një afat 25-vjeçar, duke filluar ky afat nga data 23.05.2024.*
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “operatorin e Sistemit të Transmetimit” sh.a dhe “Furnizuesin e Tregut të Lirë” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**